

# **Fjalim i Ambasadorit Anglez**

**Shkëlqesia e Tij, Dr. David Landsman**

**me rastin e Konferencës së Tretë Vjetore të Bankës së Shqipërisë,**

**Tiranë, 5 dhjetor 2002.**

Z. Guvernator, Zonja dhe Zotërinj,

Megjithëse ambasadorët marrin shumë ftesa për të folur, unë e konsideroj si një nder të veçantë që jam ftuar prej jush për t'iu drejtuar kësaj konference ndërkombëtare mbresëlënëse, e cila është organizuar nga një ndër institucionet e mëdha të Shqipërisë. Pjesëmarrja e kaq shumë bankierëve dhe ekonomistëve të shquar, përfshirë këtu edhe nga Britania e Madhe, është një shenjë (nëse do të nevojitej) që Banka e Shqipërisë është një institucion tepër i respektuar dhe anëtar aktiv i komunitetit ndërkombëtar të bankingut qendror.

Tema juaj e konferencës është nga më të rëndësishmet. Ne duhet të studiojmë historinë tonë për të planifikuar të ardhmen. Nuk ka dyshim që Banka e Shqipërisë ka luajtur një rol të shquar në tranzicionin e vështirë të vendit. Ajo është një ndër institucionet e vendit, që ka patur më shumë sukses dhe që tashmë gëzon me të drejtë kredibilitet më të madh, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Nisur nga historia problematike e kohëve të fundit, rekordi i saj në sigurimin e stabilitetit monetar është mbresëlënë, si në rajon ashtu dhe më gjerë.

Në qoftë se dhjetë vitet e fundit kanë qenë rreth tranzicionit për Shqipërinë, dhjetë vitet e tjera (dhe më pas) do të jenë sigurisht rreth integritit evropian. Është momenti i duhur që Komisioneri Evropian Chris Patten sot viziton Tiranën. Ai do të konfirmojë se në fillim të vitit tjetër do të nisë hapja historike e bisedimeve për një Marrëveshje Stabilizimi dhe Asocimi. Banka e Shqipërisë do të duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Integriti evropian nuk mund të bëhet pa zhvillimin ekonomik, për të cilin stabiliteti monetar është një kusht paraprak. Forcimi i sundimit të ligjit ekonomik është, gjithashtu, një kërkesë e domosdoshme, ku roli mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë do të jetë i domosdoshëm. Gjithashtu, kërkohet mbikëqyrje e efektshme për luftën kundër pastrimit të parasë, duke forcuar mbrojtjet tona kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Shkurtimisht, Banka e Shqipërisë duhet të luajë një rol thelbësor në ndihmën ndaj Shqipërisë për të realizuar të ashtuquajturin "Kriteret e Kopenhagenit" për anëtarësi në Bashkimin Evropian. Me fjalë të tjera, Banka e Shqipërisë mund të kontribuojë në stabilitetin politik, në zhvillimin e demokracisë dhe të institucioneve të efektshme. Ajo mund të kontribuojë në funksionimin e ekonomisë së tregut, e cila mund të sigurojë rritje të besueshme. Gjithashtu, ajo mund të kontribuojë në mundësinë e Shqipërisë për të implementuar *acquis communautaire* ose legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Siç është diskutuar deri tani në konferencë, një ndër karakteristikat më të rëndësishme të Bankës së Shqipërisë është pavarësia e saj operationale, e ndërthurur me përgjegjshmërinë e duhur. Kjo është një gjë e çmuar dhe duhet të ushqehet. Një bankë qendrore e pavarur është krijuar tashmë si një kusht për integritin evropian.

Qeveria angleze, e cila mori pushtetin në maj të vitit 1997, me një lëvizje befasuese dhe kurajoze, veptoi menjëherë për t'i dhënë Bankës së Anglisë pavarësinë e saj, në një kohë kur çështja ishte ende shumë e diskutueshme në vendin tim. Ne besojmë që ky vendim ka dhënë rezultate të qarta. Kjo ka sjellë stabilitet monetar dhe ka siguruar inflacion të ulët, i cili, nga ana e tij, ka kontribuar në rritjen ekonomike, dhe duke konsideruar klimën globale aktuale, këto janë me të vërtetë arritje mbresëlënëse.

Jam i sigurt se Banka e Shqipërisë, në qoftë se vazhdon përgjatë rrugës që ka ecur gjatë viteve të fundit, mund të vazhdojë të japë kontributin e vet në zhvillimin ekonomik dhe demokratik të vendit. Në të njëjtën kohë ajo do të përgatitet për ditën kur Guvernatori i saj të zërë vendin e vet në tryezën e Bankës Qendrore Evropiane. Mbas dhjetë viteve shumë të suksesshme, unë kam kënaqësinë t'ju uroj edhe njëqind të tjera.